



# BULETINI

Mars 2011

Numër 3/2011

## Përmbajtja

**1. Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)**

**2. Aktivitet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)**

**3. Aktivitetet nga Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL)**

**ZHVILLIM  
PROFISIONAL  
GJYQËSOR**

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr.  
"Muharrem Fejza" pa.nr.  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069  
+381 (0) 38 512 081 +381 (0) 38  
512 095 www.kjijudicial.org  
info@kjijudicial.org

## **Aktivitetet nga Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL)**

### **Program Trajnimi për Trajnues E Drejta Penale e BE-së IGJK- Twinning**



Më 28 shkurt, 01 dhe 02 mars 2011 IGJK në bashkëpunimi me Programin për Bijnakëzim (Twinning), organizoi një trajnim të specializuar për trajnuesit gjyqësor të IGJK-së me temë “ E drejta Penale e Bashkimit Evropian”.

Gjatë këtij trajnimi trjnuesit e IGJK-së u njohën me instrumetet relevante të së drejtës penale të BE-së, Rolin e Urdhërarrestit Evropian (UAE),

si të plotësojnë formularin e UED, si të plotësojnë Urdhërin Evropian për Ngritjen dhe Konfiskim si dhe si të zbatojnë ndihmën juridike ndërkombëtare në fushën e çështjeve penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë, avokat nga të gjitha regionet e Kosovës të cilët në të ardhmen do të realizojnë trjnimet nga E Dretjta e BE-së.

## Tryezë diskutimesh-civile Konflikti Administrativ

Më 03 mars 2011, IGJK organizoi tryezën e diskutimeve me temë “Konflikti Administrativ”.

Në këtë tryezë u trajtuan risitë që përmban Ligji i ri për Konfliktet Administrative, konfliktet administrative kundër akteve të nxjerra në çështjet në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) në procedurën e konfliktit administrativ.

Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se gjyqtarët pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë risitë në Ligjin për Konfliktet Administrative (LKA- 2010);
- Të përcaktojnë llojet e konflikteve administrative;

- Të dallojnë çartë rolin dhe rëndësinë e palëve në konfliktin administrativ;

- Të procedojnë drejtë rastet e konfliktit administrativ;

- Të përcaktojnë se cilat mjete juridike, kur dhe kujt mund të paraqiten ato.

Të identifikojnë problemet e gjyqësisë administrative në Republikën e Kosovës dhe rajon dhe refleksionet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut në kontekst të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ).

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e lëmis civile dhe bashkëpunëtorët profesional nga të gjitha regjioneve të Kosovës.

## Seminar “Hartëzimi Vlerësimi dhe Zhvillimi i Sistemit të Mbrojtjes së Femijeve në Kosovë”

Më 1 deri 4 mars 2011, në Durrës të Shqipërisë, në mbështetje UNICEF-i zyra në Kosovë, në bashkëpunim me De Legibus Consulting, Law Firm. është organizuar një seminar me temë Hartëzimi, Vlerësimin dhe Zhvillimi i Sistemit të Mbrojtjes së Femijeve në Kosovë.

Qëllimi kryesor ishte që të plotësohet instrumenti i ashtuquajtur toolcit i cili ishte i përkthyer në gjuhën shqipe dhe përmbante të dhëna të detajuara dhe të rëndësishme për mbrojtjen e fëmijeve. Puna e këtij seminary është organizuar në grupe punues për plotësimin e instrumenteve të ndara në katër nën-komitete sipas natyrës dhe lidhshmërisë së funksioneve të institucioneve përkatëse.

Ky seminar u përcjellë nga një numër i lartë i përfaqësuesve të të gjitha institucioneve të vendit, organizatave joqeveritare që merreshin me të drejtat, mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijeve në Kosovë.



Me ftesë nga UNICEF, një përfaqësues nga IGJK (Udhëheqësja e PVAL) morri pjesë në këtë seminar me qëllim të dhënies së kontributit në mbështetje të projektit.

## Tryezë pune–penale Trafikimi me narkotikë te rrezikshëm dhe substanca psikotrope



Më 8 mars 2011, IGJK ka realizuar sesionin trajnues nga lëmia penale ku përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte elaborimi i elementeve të veprave penale të trafikimit me narkotik dhe substanca psikotrope. Objektivat mësimore të këtij trajnimi ishin që pjesëmarrësit

të janë gjendjeje që:

- Të vlerësojnë elementet e veprave penale lidhur me narkotikë të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;
- Të dallojnë llojet e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope;
- Të identifikojnë se cilat barna narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë janë të lejuara për përdorim;
- 

Gjatë këtij sesioni trajnues u diskutuan çështje lidhur me problemet që hasen në praktikë gjatë zbatimit të dispozitave të KPK, të cilat përcaktojnë elementet e veprës penale **trafikimi me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotrope** si dhe sanksionet penale lidhur me këto vepra penale.

Gjithashtu u shtjelluan çështje që kanë të bëjnë me profilin, shkallën, nivelin e pjesëmarrjes, rolin e individit, apo të individëve, të cilët në të shumtën e rasteve veprojnë në grupe, kur e kryerjejn veprën penale të përmendur më lartë.

## Tryezë pune Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit IGJK + US DOJ

Më 9, 10 dhe 11 mars, si dhe më 14,15 dhe 16 mars 2011, Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-ve (OPDAT) dhe Institutit Kombëtar të Avokimit gjatë Gjykimit (NITA) të SHBA-ve në kuadër të Programit të Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor si dhe Programit të Trajnimeve për Avancim ka realizuar dy sesione trajnuese treditore me temë: “Ndërtimi i Shkathtësive të Përfaqësimit gjatë Gjykimit”

Objektivë kryesore e këtyre trajnimeve ishte që pjesëmarrësit të jenë në gjendje të përdorin teknikat më të avancuara të përfaqësimit gjatë gjykimit .

Çështjet të cilat janë përfshirë gjatë këtyre sesioneve trajnuese kryesisht kishin të bënin me teknikat e marrjes në pyetje të drejtperdrejtë, të tërthortë, vënia në dyshim, rimarrja në pyetje të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, si dhe teknikat e paraqitjes së fjalës hyrëse dhe argumentimit përfundimtar, si nga ana e prokurorit ashtu edhe nga ana e avokatit mbrojtës.

Gjatë këtyre trajnimeve pjesëmarrësve ju mundësua që përmes punës në grupe të demonstrojnë shkathtësitë e tyre të përfaqësimit gjatë gjykimit, duke punuar rreth një rasti praktik dhe duke përdorur teknikat e prezantuar nga trajnuesit vendor të trajnuar posaçërisht për këtë trajnim.

Gjithashtu, të gjitha prezantimet e pjesëmarrësve janë incizuar, me qëllim të marrjes së sugjerimeve dhe udhëzimeve për paraqitjen e tyre si dhe në fund pjesëmarrësve u janë shpërndarë certifikatat për përfundimin me sukses të trajnimit.

Me këtë rast këshilltarja ligjore e Ambasadës Amerikane në Kosovë, znj. Kimberly Moore shprehu, kënaqësi të veçantë për përgatitjen profesionale dhe avancimin e vazhdueshëm të stafit trajnues sipas programit NITA-s dhe njëkohësisht e vlerësoj lartë kontributin e trajnuesve të IGJK-së në organizimin dhe realizimin me sukses të trajnimit.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha nivelet dhe regjionet e Kosovës.

## Tryezë pune-civile Mbrojtja nga Dhuna në Familje

Më 15 mars 2011, IGJK organizoi tryezën e punës me temë “Mbrojtja nga dhuna në familje”. Çështjet të cilat u shtjelluan gjatë punës së kësaj tryeze u përqendruan në shpjegimin e masave për mbrojtjen kundër dhunës në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (LMDHF), Procedura për mbrojtjen nga dhuna në familje si dhe vendimet gjyqësore me të cilat caktohen këto masa.

- Qëllimi i kësaj tryeze ishte ngritja e nivelit të aplikimit efikas dhe adekuat të masave për mbrojtjen kundër dhunës në familje.
- Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se gjyqtarët pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje që: Të dallojnë rolin e masave mbrojtëse sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (LMDHF).
- Të zbatojnë masat mbrojtëse sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje .
- Të dallojnë karakteristikat dhe llojet e masave mbrojtëse sipas LMDHF.

Të dallojnë organet kompetente për shqiptimin e masave mbrojtëse

Të hartojnë aktvendimet lidhur me Urdhrin për mbrojtje, Aktvendimin për Urdhrin për mbrojtje emergjente si dhe Aktvendimin e përkohshëm të Urdhrit për mbrojtje emergjente.

- Të zbatojnë aktvendimet lidhur me masat mbrojtëse të përcaktuara me LMDHF.

Të përmirësojnë bashkëpunimin në mes gjykatave, Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK-së) dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS) në lëmin e mbrojtjes efikase nga dhuna në familje. Të unifikojnë praktikën gjyqësore në lëmin e masave mbrojtëse për mbrojtje nga dhuna në familje që zbatohet nëpër gjykata të regjioneve të ndryshme në Kosovë.

Pjesmarrës ishin gjyqtarët, bashkëpunor profesional nga të gjitha regjionet e Kosovës si dhe Përfaqesues nga Ministria e Drejtësisë dhe zyrëtarë nga SHPK.

## Tryezë pune : “Kontrata për Ndërtimin”



Më 17 mars 2011, IGJK organizoi tryezën e punës me temë “Kontrata për Ndërtimin”. Gjatë punës së kësaj tryeze u shtjelluan temat si: Elementet thelbësore të kontratës për ndërtimin, burimet dhe efektet juridike, pjesëmarrësit në kontratë, klauzolat e veçanta, llojet e veçanta të kontratës, ndërtimi i përbashkët dhe mënyrat e shuarjes së kësaj kontrate. Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se

Gjyqtarët përfundimit të tij do të jenë në gjendje:

- Të interpretojnë kornizën e përgjithshme ligjore për ndërtimet që përmban Ligji për Detyrimet i Kosovës dhe aktet tjera ligjore në fuqi.
  - Të njohin praktikën e ndërtimeve që nga viti 1999 dhe esencën e problemeve ligjore dhe joligjore lidhur me kontratat e ndërtimit.
  - Të dallojnë elementet thelbësore të Kontratës për Ndërtimin.
  - Të dallojnë të drejtat e investuesit dhe kryerësit të punës.
  - Të përcaktojnë çartë përgjegjësin për dëmin nga ndërtimet.
  - Të dallojnë llojet e kontratave të ndërtimit dhe shpjegojnë mënyrat e shuarjes së tyre.
  - Të unifikojnë praktikën gjyqësore në lëmin e zbatimit të legjislacionit të ndërtimit që zbatohet në Kosovë.
- Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Masat dhe Dënimet Alternative ndaj të Miturve-Risitë e Kodit të Drejtësisë për të Mitur

Më 22 mars 2011, u realizua seminari me temë “Masat dhe Dënimet Alternative ndaj të Miturve - Risitë e Kodit të Drejtësisë për të Mitur”.

Në këtë seminar u trajtuan kryesisht masat e diversitetit, llojet, qëllimi, kushtet dhe kohëzgjatja e masave të diversitetit si dhe risitë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Gjithashtu u diskutua lidhur edhe llojet e dënimeve alternative për të mitur, dënimi me gjobë dhe dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët vendor nga të gjitha regjionet e



Kosovës si dhe tre pjesmarrës (gjyqtarë dhe zyrtarë ligjorë) nga EULEX.

## Tryezë në nivel ekspertesh: Ligji për Procedurën Kontestimore

Më 23 mars 2011 IGJK organizoi një tryezë diskutimesh në nivel të ekspertëve me temë “Ligji për Procedurën Kontestimore”.

Gjatë punës së kësaj tryeze u shtjelluan çështjet që kanë të bëjnë me dispozitat ligjore të LPK-së lidhur me:

Përgjigjen në padi-paqartësitë dhe mundësitë e plotësimit dhe ndryshimit të LPK-së, propozimet për ndryshimet eventuale të dispozitave ligjore lidhur me sigurimin e kërkesëpadsisë dhe procedura në shkallë të dytë sipas ankesës si dhe aplikimi i parimit të gjykimit të drejtë.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte thellimi i njohurive lidhur me dispozitat ligjore të LPK-së që kanë të bëjnë me padinë dhe procedurën në shkallë të dytë sipas ankesës.

Rëndësia e këtij trajnimi konsiston në atë se gjyqtarët pas përfundimit të tij do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë paqartësitë e dispozitave të LPK-së lidhur me përgjigjen në padi dhe nevojën e plotësimit dhe ndryshimit të tyre.

- Zbatojnë drejt dispozitat e nenit 296, 394 dhe 397 të LPK-së.

- Dallojnë qartë kompetencën e gjykatës së shkallës së dytë për sigurimin e kërkesëpadsisë.

- Listojnë shkaqet për të cilat mund të goditet aktgjykimi.

- Zbatojnë drejt procedurën që zhvillohet sipas ankesës.

Dallojnë se cilat vendime mund t'i merr gjykata e shkallës së dytë për ankesën.

Përfitues të kësaj tryeze ishin edhe gjyqtarët e lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës, veçmas gjyqtarët e rinj të porsaemëruar.

## Tryezë diskutimesh E Drejta për Liri dhe Siguri (Neni 5 KEDNJ)



Më 24 mars 2011, IGJK ka realizuar një sesion trajnues nga Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ).

Qëllimi i këtij trajnimi ishte analizimi i detajuar i nenit 5 të KEDNJ-së. Përqendrimi kryesor i

trajnuesve kishte të bëjë me arsyet e privimit nga liria dhe kohëzgjatjen e këtij privimi.

Përmes shembujve praktik u bë një vështrim i detajuar se në cilat raste mund të shkelet ky nen, dhe nëse ndodhë, kjo shkelje paraqet cenim të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

- Objektivat mësimore të këtij trajnimi ishin që pjesëmarrësit të janë në gjendje të: Të interpretojnë nenin 5 të KEDNJ;
- Të vlerësojnë se çdo heqje e lirisë të jetë në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj dhe gjithnjë duke e zbatuar KEDNJ;
- Të harmonizojnë aplikimin praktik të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe të KEDNJ.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Program Trajnimi për Trajnues E Drejta Civile e BE-së IGJK- Twinning

Më 28, 29 dhe 30 mars 2011 IGJK në bashkëpunimi me Programin për Bijnakëzim (Twinning), organizoi një trajnim të specializuar për trajnuesit gjyqësor të IGJK-së.

Në këtë trajnim u trajtua e Drejta Civile e BE-së dhe instrumentet relevante ligjore të saj për mbrojtjen e konsumatorit.

Në fokus të këtij trajnimi ishte roli i legjislacionit të BE-së për mbrojtjen e konsumatorit, roli i Rregullorës së Këshillit Evropian (EC- Bruksel I) nr.44/2011 mbi juridiksionin dhe njohjen e përmbarimit të aktgjykimeve në çështjet civile dhe ekonomike, mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktuese dhe jo kontraktuese.

Gjatë këtij trajnimi janë prezantuar edhe raste nga parkatika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luxemburg.



Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë, avokat nga të gjitha regjionet e Kosovës të cilët në të ardhmen do të realizojnë trajnimet nga E Drejtja e BE-së.

## Seminar Kundërvajtje Të Miturit si Kryes të Veprave Kundërvajtëse

Të miturit si Kryes të Veprave Kundërvajtësve ishte temë e një trajnimi që u organizua më 31 mars 2011. Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesmarrësit të aplikojnë në mënyrë të drejtë parimet procedurale ndaj të miturve si të dyshuar ose kryes të veprave për kundërvajtje nga të gjitha regionet e Kosovës. Kundërvajtës si dhe masat edukative dhe dënimet të cilat mund të shqiptohen ndaj të miturve në procedurën kundërvajtëse. Gjatë këtij seminary u diskutuan disa raste nga praktika lidhur me këtë lëmi. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët vendor nga të gjitha regjionet e Kosovës si dhe tre pjesmarrës (gjyqtarë dhe zyrtarë ligjorë) nga EULEX.



### **2. Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA)**

#### **Moduli - Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale”**

Më 1 dhe 2 mars 2011, IGJK në kuadër të Programit të Trajnimeve për Avancim realizoi sesionin e radhës me temë “ Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve në hetimin e veprave penale, hartimin e aktakuzave dhe paraqitjen e ankesave më cilësore ndërsa për gjyqtarët në hartimin më të mirë të vendimeve gjyqësore, arsyetimin e tyre më të mirë dhe ngritjen e shkathtësive për udhëheqjen e drejtë të shqyrtimeve gjyqësore.

Objektivat kryesore të këtij trajnimi ishin: identifikimi dhe analizimi i dispozitatve që kanë të bëjnë me rastet e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim dhe anasjelltas, zbatimi i masës punë në dobi të përgjithshme, zbatimi i gjysmë lirisë dhe hartimi dhe arsyetimi i vendime gjyqësore më cilësore.

Në fokus të këtij trajtimi dy ditore kanë qenë kryesisht institutet juridike që kanë të bëjnë me: zëvendësimin e dënimit, gjysmë lirinë dhe paraburgimin, vrasjen e rëndë, konfiskimin e dobisë



Pasurore të fituar me vepër penale, mbrojtjen e detyruar, rregullat e marrjes së provës, hartimin arsyetimin dhe shpalljen e aktgjykimit, paralajmërimin e ankesës dhe ankesën e prokurorit, si dhe procedurën gjyqësore dhe gjykimin e drejtë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga niveli komunal dhe i qarkut të cilët ishin emëruar gjatë procesit të emërimit dhe rrimërimin.

## Moduli: Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë



Më 24 dhe 31 mars 2011, IGJK në kuadër të Programit të Trajnimeve për Avancim realizoi sesionet e radhës me temë “ Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi i përfituesve

me bazën ligjore e cila e rregullon pranimin e fajësisë dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, çështjet kontestuese që paraqiten në vështirim të zbatimit praktik dhe skepticizmit të shprehur edhe nga e komunitetit juridik ndaj këtij instituti.

Qëllim tjetër ishte inkurajimi i prokurorëve që kur ekzistojnë rrethanat adekuate, pa e cenuar interesin e drejtësisë, të aplikojnë këtë institut për

shkak të ekonomizimit të procedurës, zvogëlimit të lëndëve dhe shumë përparësive tjera.

Në fokus të trajtimit ishin dispozitat që kanë të bëjnë me rastin e zbatimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, veprimet e gjykatës me marrëveshjen e pranuar dhe mjetet juridike në procedurat e marrëveshjes.

Për të zberthyer këtë materie u përdorën edhe shumë shembuj nga praktika gjyqësore vendore si dhe nga vendet në rajon.

### 3. Aktivitetet nga Programin Fillestar për Arsimim Ligjor ( PFAL)

#### Trajnimet e PFAL III

Gjatë muajit mars kanë vazhduar trajnimet për fazën e dytë dhe të tretë të gjeneratës së tretë të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor.

Këto trajnime kandidatët i kanë ndjekur varësisht nga profili që iu është caktuar, ku kandidatët për gjyqtarë kanë ndjekur trajnime në module të ndryshme nga ata për prokurorë. Secili grup ka pasur nga 12 module trajneuse.

Trajnimet në fazën e dytë do të vazhdojnë deri në fund të muajit maj, ku në fund të trajnimeve të kësaj faze kandidatët do t’iu nënshtrohen

provimeve për secilin modul trajnues që kanë ndjekur trajnime.

Ndërsa trajnimet në fazën e tretë kandidatët i kanë vijuar në gjykata apo prokurori varësisht ku janë vendosur sipas profilit të tyre.

Trajnimet praktike janë mbajtur nën mbikëqyrjen e Mentorit gjyqtarë apo prokurorë, sipas programit të përcaktuar nga IGJK në koordinim me Koordinatorët e Mentorëve.

Këto trajnime janë ndjekur nga 32 kandidatë.



## Shpallja publike për regjistrim të kandidatëve për Provim Përgatitor



Në bashkëpunim dhe koordinim të ndërsjellë, KGJK, KPK dhe IGJK me 5, 6, 7 mars 2011 në gazetat e përditshme u bë Shpallja Publike për Organizimin e Provimit Përgatitor/Hyrës dhe Programit Fillestar për Arsimim Ligjor, me ç' rast

u shpallën 40 poste gjyqësore për kandidatët e ardhshëm për gjyqtarë dhe prokurorë.

Regjistrimi i kandidatëve për të marrë pjesë në këtë provim ka filluar në ditën e shpalljes publike dhe ka vazhduar deri me datën 25 mars 2011.

Regjistrimi është bërë në zyrat e KGJK-së. Zyrtarët e KGJK-së kishin për obligim që përveç tjerash të kujdesen për rregullsinë e dokumentacionit, posaçërisht përvojën e punës së kandidatëve që regjistrohen. I gjithë ky proces është mbështetur dhe ndihmuar nga zyrtarë të IGJK-së.

Gjatë kësaj kohe janë regjistruar 170 kandidatë ku 102 prej tyre kanë qenë meshkuj, 68 femra, 169 shqiptarë, 1 nga komuniteti serb.

Nga ata, 126 kandidatë e kanë preferuar profilin për gjyqtarë, ndërsa 44 profilin për prokurorë.

## Hartimi i Provimit Përgatitor për PFAL IV

Nga data 07 deri 12 mars 2011 është mbajtur tryeza e punës për hartimin e Provimit Përgatitor/Hyrës nga Komisioni për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor përbërja e të cilit ka qenë e miratuar nga Këshilli Drejtues i IGJK-së.

Në këtë tryezë pune, Drejtori i IGJK-së, z. Lavdim Krasniqi, prezantoi para anëtarëve të komisionit qëllimin, rëndësinë dhe metodologjinë e hartimit të provimit si dhe prezantoi udhëzimet e nevojshme rreth detyrave të anëtarëve të komisionit.

Ky proces u monitorua nga z. Harold D. Dampier, Jr., Shef i Sektorit për Monitorim të Sistemit Ligjor në OSBE, dhe znj. Mary Aguirre Shahin, këshilltare Speciale e OSBE-së në IGJK.

Anëtarët e komisionit kanë hartuar pyetjet nga të gjitha sferat e së drejtës mbështetur mbi ligjet e zbatueshme.



Çdo seksion i provimit dhe në fund të gjitha provimet e hartuara nga grupet punuese janë rishikuar për ndonjë pasaktësi eventuale apo gabime gramatikore në formulim.

Tryeza për hartim të provimit u mbështet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).